



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 205 Prot.

Tiranë, më 18/2 /2016

REKOMANDIM

Nr. 01, datë 18/2 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "European Trade Center" (ETC), pjesë e kompanisë "Edil-AL-IT", Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 191, datë 23/09/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "European Trade Center" (ETC), pjesë e kompanisë "Edil-AL-IT" (Nipt J61911003I), me objekt:

- Plotësimi i detyrimit për informim, (Neni 18) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe zbatimi i Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar;
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (Nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar;

Kontrolluesi "European Trade Center" (ETC) pjesë e kompanisë "Edil-AL-IT", përpunon të dhëna personale (imazhe dhe video), të subjekteve të të dhënave (punonjës dhe klientë), nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV) që vepron në ambientet e brendshme dhe të jashtme të tij.

Në kuadër të zbatimit të detyrimit për informim, (Neni 18) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar, grupi i hetimit administrativ (nëpërmjet procesverbalit të datës 07.10.2015) konstatoi:

- Një nga kamerat e pozicionuara në pjesën e pasme të godinës dhe dy kamera të tjera të pozicionuara në pjesën e përparme ishin pozicionuar nga rruga dhe trotuari duke regjistruar kalimtarët dhe mjetet automobilistike.

Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është në tejkalim të qëllimit të përpunimit që është siguria e objektit (referuar nenit 5/1/b të ligjit nr.9887).

- Xhirimet e kamerës së pozicionuar në pjesën e pasme (referuar me sipër) mbaheshin të ruajtura për një afat që e tejkalonte afatin prej 2 muajsh të parashikuar në gërmën c) pika 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", i ndryshuar. Në sistem rezultonte se xhirimi më i hershëm ishte i datës 23.06.2015.

Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi në çdo rast duhet të respektojë parimin e parashikuar në nenin 5/1/d të ligjit, në të cilin sanksionohet se kontrolluesi duhet t'i përpunojë të dhënat personale për sa kohë ekziston qëllimi. Komisioneri, nisur nga praktika ndërkombëtare, kërkesat e kontrolluesve më të rëndësishëm publikë dhe privatë, duke vlerësuar nevojën e parashikimit të një afati specifik për mbajtjen e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit CCTV, ka miratuar Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", i ndryshuar, në të cilin parashikohet një afat 2 muajor për mbajtjen e xhirimeve. Respektimi i këtij afati është i detyrueshëm për çdo kontrollues publik dhe privat që operon në Republikën e Shqipërisë.

- Kontrolluesi nuk e kishte marrë pëlqimin/miratimin e 75% të banorëve të pallatit për përdorimin e sistemit CCTV në godinën e pallatit/ambientet e përbashkëta (referuar pikës 5/b të Udhëzimit nr. 3).

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm pëlqimin e subjekteve të të dhënave personale pasi dhënia e pëlqimit legjitimon përpunimin e të dhënave.

- Kontrolluesi, në ambientet e survejuara kishte vendosur tabela informuese për kamerat të cilat nuk janë sipas formatit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", i ndryshuar.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk është respektuar plotësisht neni 18 i ligjit, pasi subjektet e të dhënave nuk janë informuar mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar, dhe mbi mundësinë për të kontaktuar me kontrolluesin nëpërmjet numrit të telefonit.

- Aksesimi në sistemin CCTV është i kufizuar dhe në ambientet e mirëmbajtjes së sistemit ishin marrë masa për sigurinë fizike (ambient me çelës). Kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore të veçantë për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", i ndryshuar, dhe në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në kuadër të garantimit të sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit CCTV, është e nevojshme që kontrolluesi të hartojë rregulla specifike (të shkruara) mbi sigurinë e përpunimit, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e aksesit, afatet e mbajtjes së të dhënave personale të

përpunua nëpërmjet sistemit CCTV, etj, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.

- Në ambjentet e tualetit në katin e parë të godinës ishte pozicionuar një kamera e cila bazuar edhe në deklaratimet e përfaqësuesit të kontrolluesit por edhe nga verifikimi në sistemin CCTV, rezultoi të ishte jo aktive (fallco). Përfaqësuesi i kontrolluesit, deklaroi se qëllimi i vendosjes së saj ishte shmangia e rasteve të pakënaqshme sa i përket ruajtjes së tualetit nga dëmtimet dhe abuzimet e individëve të ndryshëm.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, pavarësisht se kamera nuk regjistron, ajo ka po të njëjtin efekt te individi, duke kushtëzuar sjelljen e tij dhe duke cënuar privatësinë (në tejkallim të qëllimit të përpunimit).

Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, Nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, grupi i hetimit konstatoi se kontrolluesi nuk e kishte realizuar detyrimin për njoftim në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar. Kjo u vërtetua nga verifikimi në regjistrin elektronik të KDIMDP-së, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, por dhe nga vetë pohimet e përfaqësuesit të kontrolluesit.

Sipas Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), kontrolluesit që gjatë aktivitetit të tyre kryejnë përpunim të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kanë detyrimin e zbatimit të të gjitha kërkesave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, atë që parashikon paragrafi 1 i nenit 21: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

Meqenëse kontrolluesi në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe në kuadër të veprimit të një sistemi video-vëzhgimi, konsiderohet se përpunon të dhëna personale, ka detyrimin ligjor që të njoftojë pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të nenit 21 të ligjit.

Gjithashtu, bazuar në nenin 25/1 të ligjit të sipërcituar, parashikohet që kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Me miratimin e ligjit, kontrolluesi nuk duhej të vazhdonte përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar Zyrën e Komisionerit. Shkelja e konstatuar, lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, cilat janë të dhënat që përpunohen, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qendror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 07.10.2015).

Në përmbajtje të procesverbalit, përfaqësuesi i kontrolluesit (me detyrë përgjegjës i mirëmbajtjes) deklaroi: “në cilësinë e përfaqësuesit të kontrolluesit **ETC “Edil-AL-IT”**, deklaroj se do të përgatisim pretendimet tona lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, në seancën dëgjimore”. Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 847/2 prot. dt. 13/10/2015 është njoftuar kontrolluesi **ETC “Edil-AL-IT”** për tu paraqitur pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit më datë 23/10/2015 ora 12:50, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit kanë deklaruar se kanë plotësuar detyrimin për njoftim në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar, dhe kanë realizuar detyrimet ligjore në kuadër të përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, (por nuk janë paraqitur prova).

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ “a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit të Procedurës Administrative:

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar, nga ana e kontrolluesit ETC, duhet:
 - Të vendosen tabelat informuese për veprimin e sistemit CCTV sipas formatit standard të miratuar nga Komisioneri;
 - Të hartohet një rregullore e veçantë për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV në të cilën të parashikohen masat e sigurisë, afatet për mbajtjen e të dhënave, të drejtat e aksesit etj;
 - Të kryhet ripozicionimi i kamerave të jashtme vetëm në anën e fasadës së godinës me qëllim garantimin e sigurisë;
 - Të fshihen nga sistemi xhirimet e kamerës së pozicionuar në pjesën e pasme, që e tejkalojnë afatin prej 2 muajsh;
 - Të merret pëlqimi/miratimi (në formë shkresore) i 75% të banorëve të pallatit për përdorimin e sistemit CCTV në godinën e pallatit/ambientet e përbashkëta;
 - Të hiqet kamera fallco e pozicionuar në ambientet e tualetit pasi konsiderohet ambient i papërshtatshëm.
2. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e

të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse.

3. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 18/02/2016

